

PROCESVERBAL
nga seanca e 38-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 23.11.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: Tosho Markoski, drejtues i SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë.

Z. Petrushevski hapi seancën e 38-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:50 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski propozoi që Pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 të arsyetohen me një hyrje dhe diskutim të përbashkët, dhe votimi të jetë individual për secilën prej tyre, sepse ato i referohen të njëjtit medium që ka shkelur disa nene të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 37-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 16.11.2023.
2. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e nenit 51 paragrafi 1 të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e nenit 98 paragrafi (1) të LSHMAAV.

6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e nenit 14 të Ligjit për Media.
7. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR HARAÇINA nga fsh.Haraçinë.
8. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR VISTELL nga Shkupi.
9. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të MJEKUT POPULLOR SHPKNJP nga Shkupi, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
10. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të QËNDRËS INFORMATIVE KULTURORE SERBE SPONA nga Shkupi, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
11. Propozim - aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë.
12. Propozim – aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles.
13. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja adaptive dhe preventive e softverit ekzistues për analizë të programeve në RA dhe TV NAVS.
14. Propozim për dhënien e miratimit për sjelljen e vendimit për transformimin e vendit të punës të 1 (një) të punësuarit në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
15. Propozim – vendim për pagesën e dëmshpërblimit për vdekjen e anëtarit të familjes.
16. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 37-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 16.11.2023 2023, me tekstin e propozuar.

Pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6

Këshilli i Agjencisë nuk ishte kundër propozimit të z. Petrushevski, që pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 të arsyetohen me një hyrje dhe diskutim të përbashkët dhe votimi të jetë individual për secilën prej tyre.

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova ka shpjeguar propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 50 paragrafi (3), nenit 51 paragrafit (1), nenit 92 paragrafët (1) dhe (3), neni 98 paragrafit (1) të gjitha nga LSHMAAV dhe shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo pretendon se shkeljet rezultuan nga mbikëqyrja programore dhe administrative. Gjatë mbikëqyrjes programore është konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 50 paragrafi (3) dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, sepse tre emisione

janë transmetuar pa u shënuar me sinjalin paralajmërues. Në lidhje me shkeljen e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, ajo sqaroi se transmetuesi nuk e ka përmbushur detyrimin për të transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as të paktën gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që transmetonte në periudha nga ora 7,00 deri në orën 19:00. Lidhur me shkeljen e nenit 98 paragrafi (1) të LSHMAAV, ajo ka shpjeguar nga mbikëqyrja është regjistruar transmetimi i reklamave që nuk janë të ndara qartë nga pjesët e tjera të programit, përkatësisht janë transmetuar pa u shënuar me mjete optike dhe/ose të zërit, në fillim dhe në fund, gjithsej 9 herë gjatë ditës së analizuar. Nga mbikëqyrja administrative është konstatuar se ka shkelje të nenit 14 të Ligjit për media ku dy emisione janë publikuar pa impresium dhe të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV për shkak se nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve. Për të pesë shkeljet propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike. Në 4 raste, mbikëqyrja e kontrollit duhet të realizohet pas 20 ditësh, me përjashtim të rastit të reklamave të pandara, kur është 10 ditë.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt të kryer programore, nr.10-3349/1 datë 01.09.2023 dhe njëzëri konstatoi që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 9 gusht 2023 janë transmetuar disa programe artistike pa u shënuar me sinjalistikë për mbrojtjen e të miturve para fillimit dhe gjatë kohës së transmetimit të tyre.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizoj punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-3353/1 datë 01.09.2023 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 9 gusht 2023, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihen në dispozicion shfrytëzuesve.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar)

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-3333/1 datë 01.09.2023 dhe njëzëri ka konstatuar që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, sepse më 9 gusht 2023, nuk ka transmetuar të paktën 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk ka transmetuar të paktën gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që transmetonte në periudhën nga ora 7.00 deri në orën 19.00.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-3348/1 datë 01.09.2023 dhe njëzëri ka konstatuar që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 98 paragrafi (1) të LSHMAAV për shkak se më 9 gusht 2023, është regjistruar transmetim reklamues i cili nuk është i ndarë qartë nga pjesët e tjera të programit, gjegjësisht transmetohet pa u shënuar me mjete optike dhe/ose të zërit, në fillim dhe në fund.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 98 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas pikës 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-3352/1 datë 01.09.2023 dhe njëzëri konkludoi SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media sepse më 9 gusht 2023, në pjesë të programeve të transmetuara nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor.

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR HARAÇINË nga fsh.Haraçinë. Ajo shpjegoi se edhe kjo radio ka dorëzuar Njoftim se planifikojnë të bëjnë ndryshim në strukturën e pronësisë, pra që pronari ekzistues, i cili është person fizik, të largohet dhe t'i bashkohet personi juridik. Njoftimi i dorëzuar nuk ishte i plotë dhe i rregullt, dhe atyre iu kërkua ta plotësonin atë. Dokumentet janë dorëzuar sërish brenda afatit të caktuar, këtë herë të plotë dhe të rregullta. Është bërë kontroll në Regjistrin Qendror

të RMV-së, nga i cili janë marrë të dhëna se nuk ka pengesa ligjore për miratimin e ndryshimit të planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) HARAÇINË SHPKNJP fsh. Haraçinë, Haraçinë, me tekst siç është propozuar në Vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) HARAËINË SHPKNJP fsh.HARAÇINË, HARAÇINË, nuk krijohet konctremi i paligjshëm mediatik në kuptim të LSHMAAV, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Udhëheqësja Davidovska Dovleva ka shpjeguar Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR VISTEL nga Shkupi. Ajo shpjegoi se ky televizion është themeluar nga person juridik dhe ndryshimi që po planifikojnë të bëjnë ka të bëjë me daljen e personit juridik dhe hyrjen e një personi fizik i cili dhe deritani ishte themeluesi i vetëm i personit juridik. Kjo do të thotë se personi fizik që ka qenë pronar i vërtetë i televizionit tani hyn drejtpërdrejt si themelues i televizionit. Pas verifikimit nga ana e sektorit, është konstatuar se nuk ka pengesa ligjore për zbatimin e ndryshimit të planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të SHTR VISTEL SHPKNJP Shkup, me tekstin siç është propozuar në Vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR VISTEL SHPKNJP Shkup, nuk krijohet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptim të LSHMAAV, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 9

Udhëheqësja Davidovska Dovleva ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të MJEKUT POPULLOR SHPKNJP nga Shkupi për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo ka shpjeguar se me mbikëqyrjen e rregullt administrative është konstatuar se në impresium në kundërshtim me nenin 14 të LM nuk është publikuar data e saktë e botimit të këtij numri. Numri është i datës 11 tetor 2023 dhe thuhet se është shtypur më 8 janar 2023. Me shkresë është kërkuar që të deklarohen me shkrim, ndërkohë janë kontaktuar edhe me telefon, por nuk janë deklaruar. Prandaj, propozohet që të shqiptohet vërejtje publike.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.03-3866/1 datë 26.10.2023 dhe njëzëri konstatoi se Shoqërisë për veprimtari botuese, marketing dhe shërbime kompjuterike NARODEN LEKAR SHPKNJP Shkup, botues i "Naroden lekar", t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të

Ligjit për Media sepse në botimin nr.591 të "Naroden lekar" datë 11.10.2023 nuk e ka përmbushur plotësisht detyrimin nga neni 14 paragrafi (1) nga Ligji për Media.

Në pajtim me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë AktVendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj subjektit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 10

Udhëheqësja Davidovska Dovleva ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj QENDRËS INFORMATIVE KULTURORE SERBE SPONA nga Shkupi, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo shpjegoi se në edicionin e medias së shkruar "Sillovo" mungojnë më shumë të dhëna për impresium. Në këtë drejtim nga ana e Sektorit janë kontaktuar, është mbajtur takim me ta dhe pritet në të ardhmen që shkelje të tilla të mos përsëriten.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.03-3864/1 datë 26.10.2023 dhe njëzëri konstatoi që Asociacionit QENDRËS INFORMATIVE KULTURORE SPONA Shkup, botues i "Sillovo", t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media sepse në botimin nr.58 për muajin shtator-tetor 2023 nuk e ka përmbushur plotësisht obligimin nga neni 14 paragrafi (1) të Ligjit për Media.

Në pajtim me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj subjektit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë ueb faqen e Agjencisë.

Pika 11

Z. Petrushevski në lidhje me Propozim-aktvendimi për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, sqaroi se në seancën e 8-të publike është thirrur përfaqësues i medias për të dhënë shpjegim në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve, por meqenëse seanca ka filluar më herët, përfaqësuesi ka mbërritur tani, gjë që i ka dhënë mundësinë të deklarohet.

Z. Markoski, drejtues i SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, falënderoi për mundësinë për të shprehur arsyetimin e tij. Ai shpjegoi se ata e kthyen lejen sepse disi kjo ishte rrjedha e natyrshme e ngjarjeve. Pas shumë mendimeve dhe analizave të gjata, ata konstatuan se tregu dhe gjendja e përgjithshme në vend nuk i lejon të vazhdojnë punën për shkak se televizioni është një biznes i kushtueshëm, më pas kushtet e reja të punës të parashikuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio ku thuhet se duhet të jenë 6 të punësuar me orar (kohë) të plotë pune dhe sigurisht të dhënat e tjera nuk i jepnin mundësi zhvillimit të këtij biznesi, të paktën në rastin e tyre. Ai shpreson që situata me mediat e tjera në vend të mos jetë e tillë, por nga kontaktet që ka bërë, të gjithë thonë se e kanë të vështirë të menaxhojnë financat. Ai vuri në dukje se këtë vit nuk arritën të sigurojnë ndonjë projekt të huaj, ndryshe nga vitet e kaluara, kështu që dhe kjo ka qenë arsye më shumë që ata të vendosin për këtë hap. Ai bëri të ditur se ndoshta në të ardhmen do të bëjnë përpjekje për t'u rikthyer në këtë biznes, sigurisht nëse mund të gjejnë mjete (burime) financiare që aktualisht nuk i kanë. Ai deklaroi se kjo ishte arsyeja kryesore për kthimin e lejes.

Z. Fidanoski tha se me vëmendje e ka dëgjuar përfaqësuesin e TV K&M. Ai shprehu keqardhjen që kanë ardhur në këtë situatë sepse ky televizion ka shumë vite që ekziston në hapësirën mediatike. Ai tha se me vendimin e tyre, me mbylljen e kësaj medie, rajoni i Tetovës dhe Pollogut do të jenë më të varfër, por sinqerisht beson që sa më shpejt të jetë e mundur, qoftë në formë televizioni apo në ndonjë formë tjetër, do të të jenë sërish prezent si medium. Ai ka shpjeguar se Rregullorja e re ishte diçka që Këshilli duhet ta bëjë dhe për këtë është kujdesur maksimalisht që t'u qasen mundësive të të gjitha mediave, duke respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese që Këshilli duhet ta zbatojë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë.

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 12

Z. Petrushevski në lidhje me Propozim - aktvendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP Veles, sqaroi se ky është televizioni i fundit nga Velesi. Kanë qenë dy televizione, njëri prej të cilëve është renoncuar më herët, tani ky, kështu që tani në Veles nuk do të ketë televizion lokal, do të ketë rajonal nga Kavadari, por nuk do të ketë televizion lokal.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles.

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 13

Z. Trajçevski, në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja adaptive dhe parandaluese e softuerit ekzistues për analizën e programeve RA dhe TV NAVS, sqaroi se bëhet fjalë për mirëmbajtje të sistemit ekzistues të Agjencisë. Edhe më herët kontrata ka qenë për dy vite në vlerë prej 800 mijë denarë, por për ato dy vite janë shpenzuar vetëm 44 mijë denarë. Për këtë arsye tani është zvogëluar për katër herë në krahasim me atë që ishte më parë dhe nëse në këto dy vitet e ardhshme zhvillohet me këtë lloj dinamike, ndoshta dhe këto mjete të planifikuara do të jenë shumë. Por për siguri, propozohet që të shpallet furnizim publik me mjete në vlerë prej 200 mijë denarë.

Z. Petrushevski tha se ky shembull është dëshmi se edhe softuerët e vjetër mund të funksionojë mirë dhe të mirëmbahet për para të lira. Në lidhje me furnizimin, ai tha se Agjencia nuk ka nevojë t'i shpenzojë të gjitha mjetet, por vetëm nëse ka nevojë dhe paraqitet difekt.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtjen adaptive dhe parandaluese të softuerit ekzistues për analizën e programeve në RA dhe TV NAVS.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtja adaptive dhe parandaluese e softuerit ekzistues për analizën e programeve në RA dhe TV NAVS, është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, përkatësisht do të sigurohen nga Plani financiar i Agjencia për vitin 2024 dhe 2025.

Pika 14

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për sjelljen e Aktvendimit për transformimin e vendit të punës të 1 (një) të punësuarit në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai ka shpjeguar se kjo e punësuar më shumë se 5 vjet punon në Agjenci ose nëpërmjet Agjencisë për punësim të përkohshëm ose drejtpërdrejt në Agjenci për një afat të caktuar prej dy vitesh. Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik deklaroi se detyrat e punës i kryen në mënyrë profesionale dhe cilësore, ndaj propozohet që marrëdhënia e punës së punonjësës të shndërrohet nga kontratë pune me afat të caktuar në marrëdhënie pune me afat të pacaktuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të sjellë Vendim me të cilin transformohet marrëdhënia e punës e të punësuarës mr. Sanja Filipovska, Bashkëpunëtor për rregullativën dhe çështje analitike-juridike në Njësinë për çështje normative-juridike në Sektorin për çështje juridike dhe furnizime publike, në bazë të kontratës së punës me kohë të caktuar në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar, sepse i punësuarit më shumë se dy vjet punon në vend të lirë pune, për vendin e punës janë siguruar mjete financiare dhe është konstatuar se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka nevojë të përhershme nga punëtori.

Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga transformimi i marrëdhënies së punës do të rregullohen me Marrëveshje Punësimi që do të lidhet për periudhë të pacaktuar me punonjësin në fjalë.

Pika 15

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri pagesën e ndihmës financiare – dëmshpërblim për vdekjen e anëtarit të familjes së ngushtë – prindit (babait), punonjësit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), në shumë prej 15.000,00 (pesëmbëdhjetë mijë) denarë.

Mjetet e mësipërme sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë së Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 16

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02.4325/16

12.12.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.